



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.405/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Agon Ramadani – Kryetar, z. Vedat Poterqoi – Anëtar, dhe znj. Kimete Gashi – Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "PM Group SHPK& NPT PMK Inxhiniering Prokim", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material higjenik për shkolla", me nr. të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë), me datën: 14.11.2022, morri këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: : "PM Group SHPK& NPT PMK Inxhiniering Prokim", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material higjenik për shkolla", me nr. të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës,

II. Anulohet, vendimi i Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur në pikën I të këtij dispozitivi, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues : "PM Group SHPK& NPT PMK Inxhiniering Prokim", i Aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Me datën: 28.08.2022, OE ankues "PM Group SHPK& NPT PMK Inxhiniering Prokim", ka parashtruar ankesë me nr.405/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me material higjenik për shkolla", me nr.të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, kontratë për furnizim, vlera e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 45,040.00€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.09.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Me datë 08.09.2022 Eksperti Shqyrtues ka dorëzuar ekspertizën e tij me të cilën ka vlerësuar si në vijim:

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 08 Shtator 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues, me datë 9 Shtator 2022 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, bazuar në shkresat e lëndës, nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertizës.

Seanca e shqyrtimit të lëndës është mbajtur me datën: 14.11.2022, pa praninë e palëve konform nenit 24.2 të Rregullores së OSHP-së, pasi që nga provat dhe faktet e lëndës paneli shqyrtues ka vlerësuar se ka fakte, argumente e informacione të mjaftueshme që vendimi të merret edhe pa prezencën e palëve në seancën për shqyrtim kryesor.

Paneli shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde si dhe faktet dhe në rrethanat e cituara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga të dyja palët (OE dhe AK), duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë shkresave të lëndës, në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, PSH sqaron:

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt eliminimit nga ky aktivitet prokurimi, paneli shqyrtues i klasifikon si të bazuara dhe mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues e caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar duke kthyer lëndën në rivlerësim, kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Andaj, gjatë procedurës së rivlerësimit, udhëzohet AK që të bëjë sqarimet e nevojshme lidhur me pikat kontestuese të ngritura në këtë ankesë, konform nenit 72 të LPP-së si dhe 39.8 të RRUOPP-së.

Përveç të tjerash, PSH vlerëson se arsyetimet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues nuk qëndrojnë, për faktin se PSH konsideron se lidhur me deklaratën e konfirmimit AK nuk ka përpiluar kërkesë të specifikuar me të cilën kërkohet që për secilin produkt të paraqiten informacione të detajuara rreth përmbajtjes, specifikave, etj.

Andaj PSH konstaton se deklarata e paraqitur nga OE ankues, përgjithësisht përmbush kërkesën e FDT-së, si dhe nëse AK e konsideron të mangët, mundet që përmes sqarimeve të kërkojë informacionet e nevojshme konform dispozitave të lartpërmendura, prandaj eliminimi mbi këtë bazë nga PSH konsiderohet se bie ndesh me nenin 7, barazia në trajtim/jo-diskriminimi.

Vendimi lidhur me kthimin e tarifës u dha në kuptim të nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “Komuna e Gjakovës”,
- 1x1 OE - "PM Group SHPK& NPT PMK Inxhiniering Prokim",
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Z. Agon Ramadani